

PUNË PRAKTIKE NË RAIFFEISEN BANK

Banka Raiffeisen me kënaqësi fton të gjithë studentët e interesuar që të bëhen pjesë e programit të praktikës **Raiffeisener**, i cili do t'ju mundësoj të bëni hapat e parë në një ndër industritë më dinamike në treg, për të pasur më pas mundësi të ngriteni profesionalisht, formësoni shtegun tuaj të karrierës, duke përcaktuar kështu të ardhmën tuaj.

Informatat vijuese do t'ju ndihmojnë që të kuptoni procesin e konkurimit, kriteret, si dhe mënyrën e përzgjedhjes.

Programi i praktikës zgjat dy muaj (01 korrik - 31 gusht 2014);

Kriteret për aplikim:

Studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe **FShMN-së (drejtimi Matematikë financiare në banka e sigurime);**

Studentë të vitit të fundit të studimeve Bachelor;

Nota mesatare 7.5 e më lartë;

Aftësi shumë të mira të gjuhës angleze dhe punës me kompjuter;

Gatishmëri për të punuar me orar të plotë të punës (40 orë në javë);

Procesi i përzgjedhjes:

Të gjithë studentët që përmbushin kriteret e lartpërmendura do të ftohen për fazën e testimit për të testuar; njohuritë në fushën e ekonomisë, njohuritë e gjuhës angleze, aftësitë logjike dhe të matematikës;

Vetëm studentët që kalojnë testin me sukses, do të ftohen për fazën e intervistimit (intervistë e kombinuar; individuale dhe grupe);

Përfitimet shtesë:

Mundësi zhvillimi të njohurive duke kombinuar teorinë me praktikën;

Përgatitje për treg të punës duke përfituar nga përvoja unike e praktikës në Bankën Raiffeisen;

Përfitimi i miqësive të reja;

Mundësi punësimi në Bankën Raiffeisen.

KUR, KU DHE SI TE APLIKONI?

Afati për aplikim: **12 deri 23 maj 2014;**

Aplikimi vetëm përmes sistemit on-line, përmes webfaqes www.raiffeisen-kosovo.com.

Duke klikuar në fushën **Karriera**, zgjedhni **Programi i praktikës**, dhe pastaj klikoni linkun: Aplikacion për praktikë.

Të gjitha të dhënat e paraqitura në aplikacion do të verifikohen. Aplikacionet të cilat rezultojnë me të dhëna joreale do të refuzohen.